



RAPORTI VJETOR

2019

 **Institute**
local governance | informal learning

📍 bul. Partizanski Odredi 106, 1/3, 1000 Shkup

✉ info@zipinstitute.mk

☎ +38926159832

🌐 www.zipinstitute.mk

P Ë R M B A J T J A

H Y R J E	4
Reth Institutit ZIP	5
Qëllimet kryesore afatgjate	5
P R O J E K T E T	6
1. SHKOLLA E NËNAVE:PRINDËRIM PËR PAQE! 2020	6
2. MATKAMP	7
3. PARATË E MIA - PËRGJEGJËSIA IME: BUXHETIMI ME PJESËMARRJE NË KOMUNAT E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	8
4. PROMOVIMI DHE MBROJTJA E BURIMEVE NATYRORE TË SARAJIT-MATKËS	9
5. NDËRTIMI I KAPACITETEVE PËR SIGURI DHE MBROJTJR NË VEND TË PUNËS DUKE ANIMUAR KONSTITUENTËT	10
6. FORUMI ENERGJETIK I MAQEDONISË	11
7. Fuqizimi i organizatave rinore dhe atyre me bazë në komunitet për të avokuar në ofrimin e shërbimeve sociale në nivel lokal	12
A K T I V I T E T E O R G A N I Z U A R A N G A I N S T I T U T I Z I P 13	
1. KONSULTIM PUBLIKE MBI DRAFT STRATEGJINË PËR TURIZMIN E SARAJIT	13
2. FORUM DISKUTIMI PËR TRAJTIM INSTITUCIONAL TË POTENCIALIT TURISTIK TË SARAJIT	13
3. KRIJIMI DHE PREZANTIMI I FOTO ALMANAHIT	14
4. KONFERENCË PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE OJQ-T	14
5. TAKIMI FILLESTAR, FUQIZIMI I ORGANIZATAVE RINORE DHE ATYRE ME BAZË NË KOMUNITET PËR TË AVOKUAR NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE NË NIVEL LOKAL	15
6. MEMORANDUM I NËNSHKRUAR ME INSPEKTORATIN SHETËTËROR TË PUNËS	15
	15
7. MEMORANDUM I NËNSHKRUAR ME KONFEDERATËN E BIZNESIT TË MAQEDONISË	16
8. FORUMI ENERGJETIK I MAQEDONISË	16
9. TAKIMI ME FONDACIONIN E HEINRICH BÖLL	17

10.	CEREMONIA E DIPLOMIMIT – SHKOLLA E NËNAVE _____	17
III.AKTIVITETET NË TË CILAT MORI PJESE INSTITUTI ZIP _____		18
11.	SAMITI I BALLKANIT PERËNDIMOR 2019 _____	18
12.	ZIP NË FORUMIN E SIGURISË NË BEOGRAD _____	18
13.	FORUMI STRATEGJIK I BLED-IT 2019 _____	19
14.	SEMINARI I EKSPERTËVE ORGANIZUAR NGA OSBE _____	19
IV.PUBLIKIMET _____		20
1.	FOTO ALMANAH – SARAJI DHE 14 MREKULLITË E TIJ TURISTIKE _____	20
2.	STRATEGJIA E TURIZMIT - KOMUNA SARAJ _____	21
3.	PLANI STRATEGJIK I INSTITUTIT ZIP 2017 - 2021 _____	22
4.	RAPORT MBI MEF 2019 _____	23
V.DONATORËT DHE PARTNERËT _____		24
V . M e p a d u r i m p r e s i m v i t i n 2 0 2 0 _____		25

H Y R J E



Të nderuar miq,

Jemi gati të prezantojmë raportin vjetor të vitit 2019 i cili përmbledh sukseset dhe sfidat që shënuan këtë vit të veçantë. E filluam këtë vit me ëndrra, ide dhe projekte. Ashtu si dhe vitet e kaluara, gjatë këtij viti, kemi implementuar projekte lidhur me vetëqeverisjen lokale, energjinë, projekte për çështjet e papunësisë së të rinjve, luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, dialogun ndërfetar, si dhe sipërmarrjen sociale dhe zhvillimin rural.

Në vitin 2019, gjithashtu implementuam një projekt në lidhje me mbrojtjen e trashëgimisë natyrore, në këtë rast Matka. Përmes këtij projekti, kemi dashur t'i tregojmë të gjithëve bukurinë e Matkës dhe gjithashtu kemi dashur t'u japim një mundësi atyre që janë të gatshëm të uzurpojnë kanionin për të parë kanionin nga këndvështrimi i turistëve dhe jo si një mundësi për t'u pasuruar. Ne bëmë maksimumin për të ndarë dhe promovuar bukuritë e Matkës përmes një fushate intensive në rrjetet sociale.

Ky vit i Institutit ZIP është një vit i rritjes, të mësuarit, zhvillimit dhe në të vërtetë një vit, në të cilin ne e vendosëm veten në rrethin e organizatave me reputacion të lartë dhe shumë të respektuara në sektorin civil maqedonas dhe rajonal. Planet tona të ardhshme nuk do të ishin të plota pa ju. Prandaj, do të dëshironim të ndëgjojmë nga ju, siç e bëjmë gjithmonë. Shpresojmë për zbatimin e përbashkët të ndryshimeve në Maqedoninë e Veriut dhe në rajon, dhe sigurisht, festimin e sukseseve në vitin 2020. Edhe njëherë ju falënderoj që jeni me ne në 8 vitet e fundit.

Për një 2020 edhe më të suksesshëm!

Agim Selami

Drejtore Ekzekutiv



7 projekte të implementuara në 2019



+500 pjesëmarrës në aktivitetet tona



+10 shtete të involvuara në punën tonë

Reth Institutit ZIP

Instituti ZIP është një organizatë e pavarur joqeveritare e cila synon të përmirësojë proceset demokratike, sundimin e ligjit dhe zhvillimin e shoqërisë civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përmes zgjidhjeve të përshtatura për problemet më të mprehta sociale, shoqërore dhe sistematike. Një tipar kyç i punës së Institutit ZIP janë analiza gjithëpërfshirëse dhe të hollësishme, iniciativa dhe veprime në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal, poashtu edhe lidhja e proceseve të hulumtimeve dhe analizave me zgjidhje të prekshme për problemet më të aktuale dhe kontributi në proceset e krijimit të politikave. Nëpërmjet bashkëpunimit me palët e interesuara, si institucionet qeveritare, joqeveritare dhe rajonale, Instituti ZIP ka për mision forcimin e proceseve demokratike në Maqedoni, duke respektuar sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe në përgjithësi, duke ofruar zgjidhjet më të mira për problemet e qytetarëve dhe institucioneve në shoqërinë maqedonase.

Një nga tiparet kryesore të punës së Institutit ZIP është përfshirja sociale. Gjatë gjithë punës së tij, Instituti ZIP gjithmonë synon të arrijë komunitetet e cenushme dhe të marginalizuara, duke dëgjuar nevojat e tyre dhe duke përfshirë ato në proceset e gjetjes së zgjidhjeve për problemet e tyre. Duke pasur parasysh se përfshirja sociale dhe ndryshimet tejkaluese janë një nga shtyllat kryesore të punës sonë, përmes një qasje të balancuar, Instituti ZIP kontribuon në një bashkëjetesë të shumëllojshme.

Instituti ZIP ka vizionin që të shërbejë si një katalizator i ndryshimeve pozitive shoqërore, përmes një qasjeje proaktive drejt zgjidhjes së problemeve kryesore në proceset e demokratizimit. Vizioni i saj për Republikën e Maqedonisë së Veriut është një shtet demokratik shumë i zhvilluar, anëtar i Bashkimit Evropian, me qytetarë aktivë shoqëror dhe që kanë vetëdije të zhvilluar shoqërore dhe kolektive.

QËLLIMET KRYESORE AFATGJATE

- ✓ Demokratizimi i shoqërisë maqedonase
- ✓ Sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë
- ✓ Sektori civil aktiv, Qytetarë aktivë
- ✓ Forcimi i vetëdijes civile
- ✓ Politikat gjithëpërfshirëse
- ✓ Bashkëpunimi dhe dialogu afatgjatë ndërmjet sektorit joqeveritar dhe institucioneve qeveritare
- ✓ Zhdukja e sjelljeve shoqërore devijante
- ✓ Promovimi i arsimit joformal
- ✓ Promovimi i edukimit formal të qëndrueshëm
- ✓ Bashkekzistenca multietnike dhe multikulturale
- ✓ Promovimi i bashkëpunimit rajonal
- ✓ Promovimi i Eurointegritimit

P R O J E K T E T

Instituti ZIP përpiket të mbajë normën e suksesit të projekteve të miratuara dhe arriti të shënojë qarkullimin më të lartë vjetor që nga viti i themelimit të saj. Ne kemi arritur të ruajmë një rritje të konsiderueshme të fondeve në vitin 2019 në krahasim me vitin 2018. Projektet e zbatuara në vitin 2019 kanë qenë kryesisht në 4 grupe të portofolit: Demokratizimi, Integrimi në BE, Të Drejtat e Njeriut dhe Kundërshtimi i Ekstremizmit të Dhunshëm. Kemi implementuar gjithsej 7 projekte, të cilat kanë qenë burimi kryesor i financave të organizatës. Një përshkrim i shkurtër i projekteve kryesore që kanë përfunduar ose kanë filluar në 2019 është dhënë më poshtë, detaje më të hollësishme për çdo projekt mund të gjeni në www.zipinstitute.mk/projects.

1. SHKOLLA E NËNAVE: PRINDËRIM PËR PAQE! 2020

Shkollat e Nënave janë një program i organizatës “Gratë pa Kufi”, i menduar për nënat me qëllim që t’i pajisin ato me aftësi dhe vetëbesim në udhëzimin e fëmijëve të vet nëpër sfidat e adoleshencës, ndikimeve negative dhe pasigurive globale që sa vijnë e shtohen. Shkollat e Nënave krijojnë një hapësirë të sigurt për të mësuar, për të ndërtuar mirëbesim dhe për të gjetur mbështetje nga të tjerët që po përballen me të njëjtat çështje, pa paragjykim ose frikë. Vitin e kaluar programi u implementua në Saraj dhe Çair mirëpo këtë vit ne zgjeruam programin e Shkollës së Nënave edhe në 3 komuna të reja: Tetovë, Gostivar, dhe Studeniçan. Programi i Shkollës së Nënave në këto komuna filloi në Tetor 2019.



Partner:
Women without Borders



Donator:
US. Department of State



Kohëzgjatja:
Tetor 2018 - Tetor 2020



2.MATKAMP

Matka në periudhën e fundit është në titujt e lajmeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e trashëgimisë natyrore, për shkak të shpalljes së paaftësisë së institucioneve për të mbrojtur kanionin Matka nga urbanizmi informal. Përmes këtij projekti, kemi dashur t'i tregojmë të gjithëve bukurinë e Matkës. Ne dërguam një mesazh të fortë që Matka është një masë e tërë e bukurive dhe jo vetëm një mundësi për tu pasuruar. Ne i ndamë dhe promovuam bukuritë e Matkës përmes një fushate intensive në rrjetet sociale. Projekti gjithashtu përfshiu një ngjarje kampi në zemër të kanionit Matka ku mblodhi kamperë dhe shëtitës nga vendi, si dhe nga rajoni i Ballkanit.



Donator:
Ambasada e Francës



Kohëzgjatja:
Qershor 2019



3. PARATË E MIA - PËRGJEGJËSIA IME: BUXHETIMI ME PJESËMARRJE NË KOMUNAT E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të përmirësojë praktikën dhe pjesëmarrjen e palëve të interesuara lokale në procesin e buxhetimit lokal dhe të rritet efikasiteti i shpenzimit të parave komunale. Qëllimet specifike të projektit përfshijnë rritjen e përfshirjes së palëve të interesuara lokale - shoqërisë civile, komunitetit të biznesit, qytetarëve, mediave lokale - në proceset lokale të buxhetimit; Rritja e vetëdijes për njerëzit lokalë rreth asaj se si shpenzimi i parave komunale ndikon në cilësinë e tyre të jetës; Rritja e besueshmërisë dhe efikasitetit të vendimeve të qeverisjes vendore në lidhje me shpenzimet publike, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit për (nevojën për) transparencë.



Donator:
USAID Civic Engagement dhe
Finance Think



Kohëzgjatja:
Maj 2017 - Maj 2020



4. PROMOVIMI DHE MBROJTJA E BURIMEVE NATYRORE TË SARAJIT-MATKËS

Krijimi i strategjisë lokale për promovimin dhe mbrojtjen e burimeve natyrore të Sarajit - Matka. Në kuadër të këtij projekti, ne mbajtëm një konsultim publik për të diskutuar draft verzionin e strategjisë së turizmit të Sarajit në Qendrën Ekspozuese Matka. Në këtë ngjarje, administrata komunale, popullata lokale, organizatat e shoqërisë civile dhe bizneset vendore patën rastin të diskutojnë projekt-propozimin e Strategjisë së Turizmit në Saraj të përgatitur së fundmi nga Instituti ZIP në përputhje me koordinimin me qeverinë lokale të Komunës së Sarajit dhe Qytetin e Shkupit. Poashtu u krijua një Foto Almanah për të treguar vendet turistike të Sarajit dhe për të dhënë informacione më të hollësishme rreth tyre.



Donator:
Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë



Kohëzgjatja:
Korrik - Nëntor 2019



5. NDËRTIMI I KAPACITETEVE PËR SIGURI DHE MBROJTJE NË VEND TË PUNËS DUKE ANIMUAR KONSTITUENTËT

Granti që na u dha nga Shoqata Maqedonase e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (MOSHA), financuar nga Bashkimi Evropian ishte i para i këtij lloji duke marrë parasysh temën e projektit të propozuar. Është një temë që kërkon përfshirjen e më shumë palëve të interesuara që do të bëjnë punën tonë në të ardhmen në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Aktivitetet e planifikuara të cilat kishin për synim arritjen e rezultateve të propozuara ishin njohja e palëve të interesuara, vendosja e komunikimit me ta dhe fillimi i një iniciative për shënimin e fillimit të bashkëpunimit, siç është nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit.



Donator:
European Union



Kohëzgjatja:
Janar - Gusht 2019



6. FORUMI ENERGJETIK I MAQEDONISË

Edicioni i dytë i Forumit Energjetik të Maqedonisë u mbajt më 15-17 maj 2019 në Strugë, Maqedonia e Veriut, dhe u organizua nga ADM ESM – Energjia Elektrike SH.A. e Maqedonisë Veriore, Ambasada Amerikane në Shkup, Instituti ZIP dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Misioni i forumit të energjisë ishte të kontribuojë në një shkëmbim më të gjithanshëm, gjithëpërfshirës dhe të drejtpërdrejtë të njohurive dhe ideve mbi procesin e tranzicionit të energjisë në sektorët e energjisë evropiane, rajonale dhe maqedonase. Forumi i Energjetik vazhdoi të ishte një platformë e ndryshme dhe e nivelit të lartë për palët e interesuara në fushën e energjisë për të diskutuar sfidat e energjisë, politikat dhe bashkëpunimin në të ardhmen. Forumi Energjetik pata pati për synim të mundësoj politika të përmirësuara dhe ndërtimin e një rrjeti bashkëpunimi të qëndrueshëm.



Donator:
ADM ESM – Energjia Elektrike SH.A. e
Maqedonisë Veriore



Kohëzgjatja:
15-17 Maj 2019



7. FUQIZIMI I ORGANIZATAVE RINORE DHE ATYRE ME BAZË NË KOMUNITET PËR TË AVOKUAR NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE NË NIVEL LOKAL

Ky projekt u inicua nga shndërrimi demokratik dhe përvoja me demokratizimin e pushtetit vendor dhe përfshirjen sociale të komuniteteve romë në shtetet e Vishegradit. Qëllimi i projektit është që të fuqizojë organizatat rinore dhe thelbësore në Shqipëri dhe Maqedoni për të avokuar për ofrimin e shërbimeve më të mira sociale në nivelin lokal përmes kapaciteteve të zgjeruara dhe shkëmbimit të përvojave me shtetet e Vishegradit. Fokusi i këtij projekti është tek rinia dhe organizatat e shoqërisë civile që punojnë në çështje të përfshirjes sociale dhe të drejtave të njeriut të pakicave dhe grupeve të marginalizuara, siç janë romët. Në nivelin e ndikimit, kishim për qëllim të mbështesim zhvillimin e një shoqërie civile më të gjallë në nivelin lokal duke ndikuar politikat dhe proceset e vendimmarrjes për përfshirjen sociale dhe përmirësimin e aksesit të shërbimeve sociale për komunitetet e marginalizuara dhe pakicat që jetojnë në Shqipëri dhe në Maqedoninë Veriore.



Donator:
Fondi Ndërkombëtar i
Vishegradit



Kohëzgjatja:
Qershor 2019 - Qershor 2020



AKTIVITETET E ORGANIZUARA NGA INSTITUTI ZIP

1.KONSULTIM PUBLIKE MBI DRAFT STRATEGJINË PËR TURIZMIN E SARAJIT



30.03.2019, Qendra Ekspozuese Matka

Në këtë ngjarje, administrata komunale, popullsia lokale, organizatat e shoqërisë civile dhe bizneset lokale kishin mundësinë të diskutojnë për draft Strategjinë e Turizmit në Saraj, e përgatitur së fundmi nga Instituti ZIP në përputhje me koordinimin mes Komunës së Sarajit dhe Qytetit të Shkupit.

2.FORUM DISKUTIMI PËR TRAJTIM INSTITUCIONAL TË POTENCIALIT TURISTIK TË SARAJIT



27.08.2019, Qendra Ekspozuese Matka

Ekspertë në fushën e turizmit dhe zhvillimit rural morën pjesë në Forum Diskutimin për trajtimin institucional të potencialit turistik të Sarajit. Ekspertët diskutuan nevojën dhe trajtimin institucional të turizmit rural dhe përfitimet e turizmit për sa i përket zhvillimit ekonomik lokal. Ky projekt ishte në përputhje të plotë me memorandumin e bashkëpunimit të nënshkruar mes komunës së Sarajit dhe Institutit ZIP.

3. KRIJIMI DHE PREZANTIMI I FOTO ALMANAHIT



27.08.2019, Qendra Ekspozuese Matka

Një pjesë kryesore në projektin e krijimit të një strategjie lokale për promovimin dhe mbrojtjen e Burimeve Natyrore të Saraj - Matka ishte veprimtaria e krijimit të një Foto Almanahi që përfshin fotografi të Sarajit dhe vendeve turistike të tij. Ky Foto Almanah gjithashtu u jep lexuesve informacione dhe fakte themelore në lidhje me lokalitetet. Fotografitë u ekspozuan në Qendrën Ekspozuese Matka.


4. KONFERENCË PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE OJQ-T



27.09.2019, Tiranë, Shqipëri

Konferenca për ofrimin e shërbimeve sociale dhe OJQ-t ishte pjesë e një projekti rajonal të financuar nga Fondi Ndërkombëtar i Vishegradit. Ai kërkon të avokojë në avancimin e ofrimit të shërbimeve sociale për popullsitë e marginalizuar dhe pakicë në vendet e synuara nga organizatat e shoqërisë civile në nivelin lokal.

5. TAKIMI FILLESTAR, FUQIZIMI I ORGANIZATAVE RINORE DHE ATYRE ME BAZË NË KOMUNITET PËR TË AVOKUAR NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE NË NIVEL LOKAL



09.06.2019, Instituti ZIP

Instituti ZIP zhvilloi një takim fillestar të projektit për fuqizimin e organizatave rinore dhe atyre me bazë në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut për të avokuar në ofrimin e shërbimeve më të mira sociale në nivelin lokal përmes kapaciteteve të zgjeruara dhe shkëmbimit të përvojave me vendet e Vishegradit. Fokusi i projektit janë organizatat rinore dhe ato me bazë që punojnë në çështjet e përfshirjes sociale dhe të drejtat e njeriut, të pakicave dhe grupeve të marginalizuara siç janë romët.

6. MEMORANDUM I NËNSHKRUAR ME INSPEKTORATIN SHTETËROR TË PUNËS



07.06.2019, Inspektorati Shtetëror i Punës

Instituti ZIP nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me Inspektoratin Shtetëror të Punës, aktiviteti i projektit "Ndërtimi i kapaciteteve për siguri dhe mbrojtje në vend të punës duke animuar konstituentët". Instituti ZIP dhe Inspektorati Shtetëror i Punës së bashku do të përqendrohen në prioritetet e mëposhtme strategjike: iniciativa të përpjekjeve të përbashkëta në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, promovimin e të drejtave të punëtorëve dhe mbështetje në zbatimin e projekteve që lidhen me sigurinë në punë, shëndetin dhe të drejtat e punës.

7. MEMORANDUM I NËNSHKRUAR ME KONFEDERATËN E BIZNESIT TË MAQEDONISË



11.07.2019, Konfederata e Biznesit të Maqedonisë

Instituti ZIP nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me Konfederatën e biznesit të Maqedonisë, aktiviteti i projektit "Ndërtimi i kapaciteteve për siguri dhe mbrojtje në vend të punës duke animuar konstituentët". Instituti ZIP dhe Inspektorati Shtetëror i Punës së bashku do të përqendrohen në prioritetet e mëposhtme strategjike: iniciativa të përpjekjeve të përbashkëta në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, promovimin e të drejtave të punëtorëve dhe mbështetje në zbatimin e projekteve që lidhen me sigurinë në punë, shëndetin dhe të drejtat e punës.

8. FORUMI ENERGJETIK I MAQEDONISË



15-17.05.2019, Strugë, Maqedonia e Veriut

Edicioni i dytë i Forumit Energjetik të Maqedonisë u mbajt më 15-17 maj 2019 në Strugë, Maqedonia e Veriut, dhe u organizua nga ADM ESM – Energjia Elektrike SH.A. e Maqedonisë Veriore, Ambasada Amerikane në Shkup, Instituti ZIP dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. MEF 2019 u organizua në pesë panele. Paneli1: "Tranzicioni i Energjisë në botë dhe Sfidat Rajonale për t'u anëtarësuar në Trendin Global". Paneli2: 'Gratë në Energji, Mundësi dhe Sfidat për Baraspeshimin Gjikor'. Paneli3: "Sfidat rajonale në furnizimin me gaz natyror". Paneli4: "Teknologjitë e reja dhe burimet e rinovueshme". Paneli5: 'Efikasiteti i energjisë - Faktori kryesor për zvogëlimin e konsumit të energjisë pas vitit 2030'.

9. TAKIMI ME FONDACIONIN E HEINRICH BÖLL



27.11.2019, Instituti ZIP

Ekipi i Institutit ZIP u takua me koordinatorin e projektit të Fondacionit Heinrich Böll (Heinrich-Böll-Stiftung), z. Damir Zekovic për të diskutuar projektet tona të mëparshme, aktuale dhe të ardhshme, përfshirë Shkollat e Nënave dhe Forumin Energjetik të Maqedonisë. Ne diskutuam gjithashtu bashkëpunimin tonë të mundshëm në të ardhmen.

10. CEREMONIA E DIPLOMIT – SHKOLLA E NËNAVE



13.12.2019, Komuna e Çairit

Si pjesë e projektit tonë të Shkollës së Nënave, ne i ftuam të gjitha nënat pjesëmarrëse dhe të gjithë të tjerët të përfshirë në këtë projekt për një ceremoni diplomimi. Ceremonia u zhvillua në komunën e Çairit më 13 dhjetor 2019 ku të gjithë pjesëmarrësit morën çertifikata për punën e tyre të vështirë gjatë projektit. Partnerët tanë nga Austria, Organizata Gratë pa Kufij, ishin gjithashtu të ftuar në ceremoni.

I I I . AKTIVITETET NË TË CILAT MORI PJESË INSTITUTI ZIP

11. SAMITI I BALLKANIT PERËNDIMOR 2019



04.07.2019, Poznan, Poloni

Drejtori ynë z. Agim Selami dhe i nderuari z. Wojciech Tyciński, Ambasadori i Republikës së Polonisë në Shkup, morrën pjesë në Forumin e Shoqërisë Civile të organizuar në kuadër të Samitit të Ballkanit Perëndimor 2019 në Poznan.

12. ZIP NË FORUMIN E SIGURISË NË BEOGRAD



16.10.2019, Beograd, Serbi

Drejtori ynë z. Agim Selami ishte pjesë e Forumit të Sigurisë në Beograd - Duke u përpjekur për drejtësi në një botë të ndarë, organizuar më 16-18 Tetor 2019. Forumi i Sigurisë në Beograd u mbajt për vitin e nëntë, duke mbledhur 350 pjesëmarrës. Gati 100 folës nga 30 vende të Evropës dhe botës diskutuan për drejtësinë, integrimin evropian, marrëdhëniet rajonale, ndryshimin e klimës dhe pjesëmarrjen e grave në ushtri dhe politikë.

13. FORUMI STRATEGJIK I BLED-IT 2019



31.08-03.09.2019, Lubjanë, Slloveni

Nën titullin "(ri) burimet e (pa) stabilitetit", Forumi i 14 Strategjik i Bled-it, u zhvillua gjatë periudhës 31 gusht dhe 3 shtator 2019, në Lubjanë / Bled, Slloveni, dhe ishte dedikuar për të diskutuar rolin e (ri) burimeve lidhur me paqen dhe sigurinë, zhvillimin e qëndrueshëm dhe përparimin ekonomik.

14. SEMINARI I EKSPERTËVE ORGANIZUAR NGA OSBE



16-17.12.2019, Vjenë, Austri

Instituti ZIP u ftua të merr pjesë në seminarin i cila u organizua nga Njësia për Veprim kundër Terrorizmit të Departamentit të Kërcënimeve Transnacionale të OSBE-së. Seminari zgjati nga 16-17 dhjetor dhe u zhvillua në Vjenë. Seminari u përqëndrua në atë se përse mbrojtja e objektivave "të butë" kundër sulmeve terroriste është kaq kritike duke u bazuar në mësimet e marra dhe praktikatat e mira nga e gjithë zona e OSBE-së dhe sfidat që lidhen me mbrojtjen e këtyre vendeve, siç janë vendet e adhurimit dhe ngjarjet sportive.

I V . P U B L I K I M E T

Si pjesë e projekteve tona, ekipi i Institutit ZIP ka krijuar 6 botime në 3 gjuhë të ndryshme: maqedonisht, shqip dhe anglisht.

1.FOTO ALMANAH – SARAJI DHE 14 MREKULLITË E TIJ TURISTIKE

Ky botim ishte pjesë e projektit "Krijimi i strategjisë lokale për promovimin dhe mbrojtjen e burimeve natyrore të Saraj-Matka", implementuar nga Instituti ZIP. Foto Almanahi përfshin fotografi të Sarajit dhe vendeve turistike të saj. Foto Almanahi gjithashtu u jep lexuesve informacione dhe fakte themelore në lidhje me lokalitetet. Fotografitë u ekspozuan në Qendrën Ekspozuese Matka. Ju mund të lexoni Foto Almanahin në gjuhën shqipe ose maqedonase.



2. STRTAEGJIA E TURIZMIT - KOMUNA SARAJ

Strategjia përfshin një analizë të gjendjes së turizmit në Maqedoninë e Veriut, vlerësimin e gjendjes ekzistuese në lidhje me zhvillimin e turizmit në Saraj, analizën SWOT dhe PEST, hartëzimin e lokaliteteve ekzistuese turistike, planin strategjik të zhvillimit, vizionin, misionin, qëllimet strategjike, planin e veprimit, etj. Ju mund ta lexoni këtë dokument në gjuhën shqipe ose maqedonase.



3. PLANI STRATEGJIK I INSTITUTIT ZIP 2017 - 2021

Megjithëse plani strategjik është krijuar tashmë, këtë vit ne kemi vendosur të përfshijmë qëllimin strategjik 4: kontributin për sigurinë në punë, duke pasur parasysh punën tonë me Shoqatën Maqedonase për Siguri dhe Shëndet në Punë (MOSHA). Ne kemi krijuar qëllimet e mëposhtme strategjike:


Qëllimi strategjik 1: Përmirësimi i situatës dhe gjetja e zgjidhjeve të qëndrueshme për problemet në nivelin lokal;

Qëllimi strategjik 2: Kontributi në zhvillimin e shoqërisë civile në nivelin lokal;

Qëllimi strategjik 3: Kontributi në përmirësimin e sundimit të ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;

Qëllimi strategjik 4: Kontributi në sigurinë dhe mbrojtjen në punë;

Qëllimi strategjik 5: Promovimi i vlerave të BE-së në nivel lokal dhe kombëtar;



4. RAPORT MBI MEF 2019

Misioni i edicionit të dytë të Forumit Energjetik Maqedonasë ishte të kontribuojë në një shkëmbim më të gjithanshëm, gjithëpërfshirës dhe të drejtpërdrejtë të njohurive dhe ideve mbi procesin e tranzicionit të energjisë në sektorët e energjisë evropiane, rajonale dhe maqedonase.

Forumi vazhdoi të ishte një platformë e ndryshme dhe e nivelit të lartë për palët e interesuara në fushën e energjisë për të diskutuar sfidat e energjisë, politikat dhe bashkëpunimin në të ardhmen. Forumi gjithashtu synonte të mundësonte politika të përmirësuara dhe ndërtimin e një rrjeti bashkëpunimi të qëndrueshëm.



Verzionin elektronik të të gjitha botimeve mund ta gjeni në faqen tonë të internetit www.zipinstitute.mk, ndarja PUBLIKIME.

**W O M E N
W I T H O U T
B O R D E R S**

CHANGE THE WORLD



RURAL DEVELOPMENT NETWORK
OF THE REPUBLIC OF MACEDONIA



M33PP



V . M e p a d u r i m p r e s i m v i t i n 2 0 2 0

Viti 2019 ka qenë një vit me shumë ulje dhe ngritje. Përderisa, ne po fillojmë kapitullin 9-të të punës së Institutit ZIP, po përfundojmë projektet, aktivitetet dhe iniciativat që kanë filluar në vitin 2019, ne në anën tjetër jemi të zënë duke ndjekur mundësi të reja dhe duke zgjeruar fushëveprimin tonë për të filluar projekte të reja. Në gjithmonë përqipemi për rritje dhe zhvillim të mëtejshëm. Prandaj, gjithmonë jemi duke punuar në mënyrë aktive në aplikimet e reja të projekteve që do të thëllonin ekspertizën tonë dhe do të zgjeronin më tej fushën e punës sonë. Ne presim një bashkëpunim dhe përfshirje më të madhe në projekte me Bashkimin Evropian dhe Këshillin e Evropës, ndoshta duke nisur një projekt ndërkufitar ndërkombëtar.

Presim të vazhdojmë bashkëpunimin me institucionet qeveritare si: Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Zyrën e Kryeministrit, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Teknologjisë Informative dhe Administratës, Ministrinë e Bujqësisë, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Mbrojtjes; njësitë e vetëqeverisjes lokale, komunat dhe organet e tyre, zyrat e kryetarëve të komunave. Sa i përket arsimit, vazhdojmë bashkëpunimin e suksesshëm me shkollat fillore, të mesme dhe universitetet shtetërore dhe private. Poashtu vazhdojmë punën tonë edhe me komunitetet fetare, dhe natyrisht me sektorin e shoqërisë civile në Maqedoninë e Veriut. Ne do të vazhdojmë bashkëpunimin me misionet e huaja dhe ndërkombëtare në Maqedoni, si dhe mediat tradicionale ku do të vazhdojmë të tregojmë punën dhe ekspertizën tonë për publikun e gjerë.

Po përqipemi të fillojmë një vit të ndryshimeve. Në ndjekjen e ndryshimeve, ne presim të mobilizojmë aftësitë dhe talentet e stafit tonë, të ndërtojmë mbi rrjetet që kemi krijuar dhe të ndikojmë duke kombinuar hulumtime të plota dhe analiza të kujdesshme me veprim në terren. Jemi të kënaqur me të arriturat tona të vitit të kaluar dhe jemi të sigurt se jemi të pozicionuar mire në sektorin civil dhe jemi gati për të zgjidhur çështjet e ngutshme që kemi identifikuar me punën tonë.

Për një 2020 të suksesshëm!

Në vitin 2020, bëjmë përpjekje për rritje të mëtejshme dhe zhvillim, duke përfshirë:

Zgjerimi i mëtejshëm i fushës së punës sonë;

Bashkëpunim dhe përfshirje më e madhe në projekte me BE dhe Këshillin e Evropës;

Rifillimi i bashkëpunimit me institucionet qeveritare në vendin tonë

Bashkëpunim me misionet e huaja dhe ndërkombëtare në Maqedoninë Veriore

Vazhdimi i bashkëpunimit të suksesshëm me shkollat dhe universitetet shtetërore dhe private

Vazhdimi i punës me komunitetet e prekshme dhe të marginalizuara dhe përfshirja e tyre në punën tonë

VI. Reporti Financiar

			Период											Контролор											
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26
Вид работа			Идентификационен број (ЕМБС)								Резервни кодекси														

Назив на непрофитната организација, – **Здружение на граѓани ЗИП ИНСТИТУТ за политики и добро владение Скопје**

Седиште- Ул. Ул.Тале Христов бр.1/4 Скопје тел- 6141854

БИЛАНС НА ПРИХОДИТЕ И РАСХОДИТЕ

во периодот од 01-01 до 31-12 2019 година

(во денари)

Ред. број	ПОЗИЦИЈА	Ознака за АОП	И з н о с	
			Претходна година	Тековна година
1	2	3	4	5
	I. РАСХОДИ			
	МАТЕРИЈАЛНИ РАСХОДИ, УСЛУГИ И АМОРТИЗАЦИЈА (202 до 210)	201	3.103.109	3.962.497
1.	Потрошени материјали	202	237.347	118.702
2.	Потрошена енергија	203	23.674	53.433
3.	Други услуги	204	1.894.371	2.599.861
4.	Превозни - транспортни услуги	205	404.616	346.507
5.	Издатоци за реклама, пропаганда и репрезентација	206		
6.	Амортизација	207		
7.	Набавна вредност на продадените материјали, стоки и услуги	208		
8.	Наемнини	209	543.101	338.806
9.	Други материјални расходи	210		505.188
	ДРУГИ РАСХОДИ (212 до 221)	211	3.467.649	2.514.741
10.	Провизија за платниот промет	212	54.265	46.166
11.	Камати на кредити и заеми	213		14
12.	Премии за осигурување	214		10.499
13.	Дневници за службено патување и патни трошоци	215	56.479	230.759
14.	Надоместоци на трошоците на работниците и граѓаните	216		
15.	Негативни курсни разлики	217	5.353	12.268
16.	Членарини	218	500	500
17.	Други расходи	219	2.777.725	1.953.269
18.	Издатоци за меѓународна соработка	220		
19.	Пренесени средства	221	573.327	261.266
	КАПИТАЛНИ И ДРУГИ СРЕДСТВА (223 +224+225)	222	34.990	432.904
20.	а) Средства за градежни објекти	223		
21.	б) Средства за опрема	224	34.990	413.048
22.	в) Други капитални средства	225		19.856

Ред. број	ПОЗИЦИЈА	Ознака за АОП	И з н о с	
			Претходна година	Тековна година
1	2	3	4	5
	ПОМОШТИ, ДОНАЦИИ И ДРУГИ ДАВАЧКИ (227+ 228 +229)	226		
23.	а) Помощи, донации и други давања на правни субјекти	227		
24.	б) Надомести и помощи на физички лица	228		
25.	в) Други помощи и давања	229		
	ПЛАТИ И НАДОМЕСТ НА ПЛАТИ (231 + 232)	230	468.308	483.178
26.	а) Вкалкулирани плати	231	468.308	483.178
27.	б) Вкалкулирани надомести	232		
28.	Даноци и придонеси кои не зависат од резултатот	233	1.353	6.244
29.	Вонредни расходи	234		
	ВКУПНО РАСХОДИ (201+ 211+ 222 + 226 + 230 + 233+ 234)	235	7.075.409	7.399.564
30.	Остварен вишок на приходи-добивка пред оданочување (250 минус 235)ако 250 >235	236	1.953.951	1.813.686
31.	Даноци, придонеси и други давачки од добивката	237		
32.	Остварен нето вишок - добивка по оданочувањето (236 минус 237)	238	1.953.951	1.813.686
33.	Вкупно (235 + 236) или (235 + 237) ако 237 е поголемо од 236 = 252	239	9.029.360	9.213.250
	ПРИХОДИ ОД ПРОДАЖБА НА ПРОИЗВОДИ, СТОКИ И УСЛУГИ (241+242)	240		
34.	Приходи од продажбата на производи и стоки	241		
35.	Приходи од услуги	242		
36.	Приходи од камати и позитивни курсни разлики	243		2.729
37.	Приходи од чланарини, подароци, Донации и приходи од други извори	244	8.688.919	7.111.434
38.	Приходи од кири и закупнини	245		
39.	Сопствени приходи	246		
40.	Други приходи	247		60.000
41.	Пренесен дел од вишокот на приходите од предходна година	248	340.440	1.953.951
42.	Вонредни приходи	249	1	85.136
	ВКУПНО ПРИХОДИ (240+ 243+ 244+ 245+246 +247+248 +249)	250	9.029.360	9.213.250
43.	Непокриени расходи (235 минус 250)	251		
	ВКУПНО (250 + 251) = 239	252	9.029.360	9.213.250

Сметководител: Име и презиме Сузана Филиповска

ЕМБГ: 1202960455075

Сметководител: Име на фирма Твинс Консалтинг ФМС

ЕМБС: 6446590

Во - Скопје

На ден - 29-02-2020

Лице одговорно за составување на билансот.



Раководител



📍 bul. Partizanski Odredi, 106 1/3, 1000 Shkup

✉ info@zipinstitute.mk

☎ +38926159832

🌐 www.zipinstitute.mk